



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Nr. ref: 159/2023
Datë: 24.07.2023

Në mbështetje të nenit 14 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 14 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nenin 26 të Ligjit Nr.04/L-037 mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 05/2019 për Arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike:

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

Shpall

KONKURS

Për zgjedhjen e personelit akademik të rregullt në Fakultetin e Sigurisë Publike

1. Një mësimdhënës për lëndët: Siguria kombëtare; Menaxhimi i Sigurisë Publike; Siguria dhe menaxhimi; Menaxhimi i Krizave; Siguria e brendshme dhe menaxhimi emergjent.

2. Një mësimdhënës për lëndët: Menaxhimi i sigurisë së informacionit; Analiza e Inteligjencës; Inteligjenca dhe hetimi; Menaxhimi emergjent dhe terrorizmi.

Procedura e zgjedhjes së personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 05/2019 për Arsimin e Lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe duhet të jetë në përputhje me standardet e Agjencisë së Akreditimit për pranueshmërinë e mësimdhënësit si bartës të programit studimor në fushën e sigurisë publike.

Kandidatët që aplikojnë duhet të kenë së paku gradën: Doktor i shkencave (Dr.sc) në fushën e sigurisë, apo në fushën penale. Si dhe duhet të ketë të publikuar së paku një punim shkencor si autor i parë apo korrespondent, punim i cili është i indeksuar në platformën SCOPUS apo WEB OF SCIENCES (SCIE, SSCI dhe AHCI), duke përjashtuar revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të MASHT.

Kandidatët që aplikojnë në konkurs duhet të dorëzojnë:

- Kërkesën për aplikim ku specifikohet pozita dhe grupi i lëndëve;
- CV-në profesionale;
- Ekstraktin e lindjes (jo me i vjetër se 6 muaj) dhe kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën e evidencës penale (jo me e vjetër se 6 muaj);
- Kopjen e diplomës, të studimeve themelore, master/magjistraturë dhe të doktoratës (të gjitha diplomat duhet të jenë të noterizuara);
- Dëshmitë për publikimet shkencore (së paku një punim të indeksuar në SCOPUS apo WEB OF SCIENCES (SCIE, SSCI dhe AHCI));
- Dëshmi për përvojën e punës në mesimdhënie në arsimin e lartë;
- Vendimin për nostrifikimin e diplomës nga MASHT (vlen për kandidatët që kanë përfunduar ndonjë nga ciklet e studimeve jashtë vendit);
- Vendimin e zgjedhjes së fundit (vlen për kandidatët të cilët janë të punësuar në ndonjë institucion të arsimit të lartë në Kosovë);
- Deklaratë me shkrim për gatishmëri për dorëheqje nga vendi paraprak i punës në rast të zgjedhjes nga AKSP (vlen për kandidatët të cilët janë të punësuar);
- Informata apo të dhëna tjera shtesë të cilat konsiderohen të rëndësishme për ata që aplikojnë;

Njohja e gjuhës angleze apo ndonjë gjuhë tjetër të huaj, është përparësi për konkurruesit.

Personeli akademik do të angazhohet në mesimdhënie në programet studimore të arsimit të lartë, kërkime shkencore, mesimdhënie në trajnime, zhvillimin e kurikulave dhe angazhime tjera në varësi të nevojave të njësisë akademike dhe institucionit.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike dhe elektronike:

- Në kopje fizike dokumentet dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në Vushtrri, Ndërtesa e Administratës, Zyra e Personelit nr. 01;
- Në kopje elektronike dokumentet dorëzohen të skanuara në e-mail-in: rekrutimi.aksp@rks-gov.net ;

Si të dhëna të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato të dhëna, të cilat janë të dëshmuara me dëshmi relevante (jo edhe ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Aplikacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara sipas kërkesave të konkursit, nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursi do të jetë i hapur **15 ditë** kalendarike nga dita e shpalljes, respektivisht deri me datën **07.08.2023** në ora 16:00.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit: www.aksp-ks.net

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit, në numrin e tel:028 590 070 ext. 210 ose 211, prej orës 08:00 – 16:00.

